



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE

MINISTRI

Nr. 10770
Prot.

Tiranë, më 10/07/2025

UDHËZIM PLOTËSUES

Nr. 19 Datë 10/07/2025

“PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM VENDOR 2026-2028”

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar Ministri i Financave:

UDHËZON

I. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028

1. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028, të miratuara nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore do të merren në konsideratë për hartimin e buxhetit të vitit 2026.
2. Parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore mbështetet në legjislacionin aktual në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, si dhe në ligjin nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar.
3. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2026, do të jenë në përputhje me nivelin e financimit të miratuar në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2026-2028, sipas detajimit të parashikimit të dërguar në fazën e parë të PBA-së për vitet 2026-2028. Efekti i rritjes së pagave për funksionet e financuara me transfertë sektoriale dhe për punonjësit e administratës së bashkisë do të reflektohet në transfertën që do ti akordohet njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2026.
4. Niveli i transfertës së pakushtëzuar dhe i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2026-2028, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financon funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2025.

5. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar/pakushtëzuar sektoriale do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës financiare përkatëse.
6. Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2026-2028 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 83 datë 05.02.2025, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028. Ai pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që njësia e vetëqeverisjes vendore do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
7. Këto vlerësime sigurojnë bazën për njësitë e vetëqeverisjes vendore për të përcaktuar tavanet e shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm.
8. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duhet të përfshijnë në Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 ,planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.
9. Procesi i miratimit të PBA-së 2026-2028 përfundimtare dhe Buxhetit Vjetor, do të realizohet nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor.
10. Programi Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 duhet të hartohet në përputhje me programet e miratuara me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar.
11. Bashkitë: Korçë, Gjirokastër, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak, Belsh, Fier, Patos, Fushë Arrëz, Skrapar, Mat, Delvinë dhe Qarqet: Shkodër, Gjirokastër, Korçë, do të vijojnë me fazën e dytë të PBA-së sipas metodologjisë së re të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave nr.8 datë 28.02.2025.

II. Afatet për Përgatitjen e Buxhetit

1. Kryetari i njësive të vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësive të vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi, bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga buxheti i shtetit.
2. Këshilli i njësive të vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik.
3. , Njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësive, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë, brenda datës 15 shtator
4. Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 tetor. Në përfundim të këtyre takimeve, sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t’u reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm, brenda datës 20 tetor 2025

III. Mbështetja Këshillimore për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

1. Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e PBA 2026-2028, vë në dispozicion për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore adresat e e-mailit: Fran.Brahimi@financa.gov.al, Elidona.Durmishi@financa.gov.al.
2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund ti drejtohen në çdo kohë Ministrisë së Financave për zgjidhjen e çdo problematike që shfaqet në lidhje me hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe plotësimin e formateve të PBA-së në fazën e dytë dhe fazën përfundimtare sipas Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor.

MINISTRI

Petrit Malaj

